

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 6
21.03.2019

NR. VENDIMI 5
25.03.2019

V E N D I M

“Për Sekuestrim Pasurie”

Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë e përbërë prej:

GJYQTAR: Luan HASNEZIRI

Asistuar nga sekretare séance **Emirjona PAHUMI**, sot në datë 25.3.2019, mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, kërkesën penale Nr. 6 Regj., me palë:

KËRKUES: Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, përfaqësuar nga prokurorët Manjola Kajana dhe Ened Nakuçi.

KUNDËR: 1. Shtetasve A.M., i biri i A. dhe T., i dtl x.x.xxxx, lindur në xxx, xxxx dhe banues në xxx xxx, me gjënëjes civile i divorcuar, me gjendje gjyqësore i padënuar në Republikën e Shqipërisë.

2. A.M., i biri i A. dhe i T., i datëlinëjes xx.x.xxxx, lindur në xxx, xxxx dhe banues në Rrugën xxxxxx xxxxxx, Tiranë, me arsim 12 klasë, me gjendje civile i pamartuar, me gjendje gjyqësore i padënuar.

PERSONA TË TRETË: 1. A.A., e bija e H. dhe e H., e dtl. xx.x.xxxx, lindur në xxx, banuese në Tiranë.

2. I.(C.) M., i biri i A. dhe T. i datëlindjes xx.x.xxxx lindur në xxxdhe banues në xxx.

OBJEKTI: Sekuestrimin e pasurive si më poshtë vijon:

- I. Pasuri garazh me sip. 23 m2, në emër të shtetasit A.M., Zona kadastrale 2183, vol 7, faqe 46, data e leshimit të certifikatës 12.4.2016, blerë me kontratën e shitblerjes, nr. 387 rep; nr. 203 kol. datë 26.3.2016 nga shoqëria “Al-Konstruksion”, me përfaqësues ligjor shtetasi B.I. në vlerën 4.000 USD.
- II. Pasuri apartament me sip. 100.5 m2, në emër të shtetasit A.M., Zona Kadastrale 2183, vol 7, faqe 146., blerë nga shoqëria “Al-Konstruksion”, me përfaqësues ligjor shtetasi B. I., me kontratën e shitblerjess nr. 386 rep; nr. 202 kol. datë 26.3.2016, për shumën 41.740 dollarë.
- III. Pasuri e llojit truall, në emër të shtetasit Sh.M.(A.M.), ZK. 3866, Nr.Pasurisë 312/202, Vol.57, Fq.95, lloji i pasurisë truall, Sip.473.50 m2. fituar me kontratën nr. 2774 rep. nr. 928 kol. datë 3.6.2008, në shumën 2.998.500 lekë, me adresë Yzberisht, Tiranë dhe është regjistruar në datë 7.5.2012.
- IV. Pasuri e llojit apartament me sipërfaqe 71 m2, ne emër të shtetasës A.A., ndodhur në zonën kadastrale të qytetit Sarandë nr. 8641-8642, volum 17, faqe 28., blerë nga shoqëria Tulo shpk me kontraten nr. 265 rep; nr. 52/1 kol në datë 13.1.2013 te noteri Genc Nikolla, në shumën 3.698.316 lekë, ku në këtë kontratë sipas prokurës së posaçme, datë 12. 1.2013, kjo shtetase është përfaqësuar nga shtetasi A.A.M..
- V. Pemtore me sipërfaqe 608 m2 në Mjull, Bathore, Tiranë, në emër të shtetasës A.A., blere nga nga shtetasi I.K., me datë 5.4.2013, kundrejt shumës 1.200.000 lekë, sipas kontratës me Nr. rep.1823, Nr. kol.36,3 të nënshkruar përpara noteres Ardjana Mehdi-Hoxha.
- VI. Apartament banimi i ndodhur në Sarandë, zona turizëm, Kanali i Çukës, i porositur në datë 5.7.2012 tek shoqëria “Tulo” shpk për ndërtim, kundrejt shumës 90.000 EURO, sipas kontratës së porosisë Nr. rep.3283, Nr. kol.1156, të nënshkruara përpara noter Genci Nikolla.
- VII. Vila dy katëshe e ndodhur në fshatin Prezë, Vorë, në pronësi të shtetasit A.M.(N.) e blerë nga shtetasi D.C., aktualisht në këtë banesë nuk banon asnjëri dhe herë pas here shkon bashkëshortja e shtetasit A.M., e cila bën pastrimin e kësaj ndërtese.
- VIII. Automjet i llojit BMË X6, me targa xxxxxxxx sekuestruar shtetasit C.M.
- IX. Automjet i llojit Fuoristrade Mercedes Benz, sekuestruar shtetasit C.M..
- X. Automjeti fuoristrade BMË X3, me targa xxxx xxxxxx xx, sekuestruar të pandehurit A.M..
- XI. Automjet i markës DODGE, me targa xx xxxx xx, sekuestruar shtetasit C.M.
- XII. Automjet i markës DODGE, me targa xx xxxxxx, sekuestruar shtetasit C.M.
- XIII. Automjet i markës Mitsubishi, ngjyrë gri, pa targa, sekuestruar shtetasit C.M.
- XIV. Automjet i markës Volsëagen Tiguan me targa xxx xxxx xx, sekuestruar shtetasit C. M..
- XV. Automjeti i markës Land Rover model Defender me targa xx-xxxx- xx. sekuestruar C.M., me datë 14.2.2017.
- XVI. Një motocikletë tip BMW model R1200 me targë xx-xxx, sekuestruar në banesën e A.M., çelësat dorëzuar nga C.M.;

BAZA LIGJORE: Nenet 3 deri në 7, 11, 12, 14 dhe 15 e vijues të ligjit nr. 10192, datë 3.12.2009 “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe

krimeve të tjerë, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, ndryshuar me ligjin nr. 24/2014 dhe me ligjin nr. 70/2017.

Gjykata pasi shqyrtoi çështjen, në dhomë këshillimi, admnistroi provat;

VËREN:

1. Procedimi Pasuror nr. 2, datë 4.3.2019, ka filluar mbi bazën e verifikimeve të kryera e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda lidhur me të pandehurit A.M., A.M. dhe familjarëve të tyre. Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton që, Prokuroria për Krime të Rënda mbi bazën e vendimit nr. 43 datë 24.4.2018 të Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, ka dërguar për gjykimin procedimin penal nr. 63/1 të vitit 2017 kundër të pandehurve: A.N. (M.), i akuzuar për veprat penale të: “*Vjedhja e bankave*”, më shumë se njëherë, “*Prodhim i mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, në formën e grupit të strukturuar, “*Krijimit dhe pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga nenët 136/2, 278/1, 28/4, 333/a/1, 2 dhe 334/1 të Kodit Penal; D.K., E.K., N.A., D.M. dhe A.Ç. , të akuzuar për veprat penale të: “*Vjedhja e bankave*”, më shumë se njëherë, “*Prodhim i mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, në formën e Grupit të strukturuar, “*Pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga nenet 136/2, 278/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal, si dhe F.Xh. i akuzuar për veprat penale të: “*Vjedhja e bankave*”, “*Prodhim i mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, në formën e grupit të strukturuar, “*Pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga nenët 136/1, 278/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal; D.S., dhe A.M. , të akuzuar për veprat penale të: “*Vjedhja e bankave*”, “*Prodhim i mbajtjes pa leje të armëve luftarake*”, në formën e grupit të strukturuar, “*Pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga nenët 136/1, 278/1, 28/4, 333/a/2 dhe 334/1 të Kodit Penal dhe me viktimë subjektet: *Uniqa Group Austria, Banka Kombëtare Tregtare sh.a, Banka Credins sh.a dhe Banka Union sh.a.*

2. Faktet kriminale për të cilën dyshohen këto shtetas janë si më poshtë vijnë: Më datë 13.2.2015, Drejtori i Departamentit të Sigurisë së Union Bank, Q. T., dhe përgjegjësjë e tregëtimit të parave në Departamentin e Thesarit, B.F., së bashku me përgjegjësit e levizjeve monetare po në Departamentin e Thesarit, I.L. dhe G.A., vendosën të transferonin një shumë të konsiderueshme monetare, në valutë, në drejtim të Bankës "Raiffeisen", në Vjenë, Austri.

3. Në orën 10:46 të datës 13.2.2015, Brunilda Ferhati, nëpërmjet postës elektronike, në mënyrë të koduar njoftoi Shoqërinë SH.R.F.S "Euro-Gjici" se, në orën 12:30, kërkohej eskortë, për transportim vlerash monetare në drejtim të Rinasit. Vlera monetare e destinuar për transport ishte 900 000 Franga Zvicerane, 800 000 Paund Britanik dhe 16.100 Euro, e paketuar në katër qese me peshë totale 49.80 kilogram. Shtetasit R.F. dhe G.G. u autorizuan të kryenin procedurat e marrjes, dorëzimit dhe shoqërimit të vlerave monetare, ndërsa në përbërje të eskortës u përfshinë S.F., në rolin e përgjegjësit, I.S. dhe D.D. si personel shërbimi, A.D. drejtues i mjetit të blinduar dhe, T.H. drejtues i mjetit shoqërues.

4 Në orën 12:30, grupi i shoqërimit me mjetin blind, "Land Rover", fuoristradë, me ngjyrë të bardhë, me targa xx xxx xx, së bashku me makinën e shoqërimit, "Volksvagen", po me ngjyrë të bardhë, u vendos tek hyrja e tunelit për në bankë. Roja i bankës, i lajmëruar nga shoqëruesi i vlerave monetare, hapi qepenin dhe lajmëroi informacionin për mbërritjen e ekskortës. R.F., shoqëruesi i vlerave monetare, lajmëroi personat përgjegjës të departamentit të thesarit. Sasia e parave, e përgatitur paraprakisht, u shoqërua nga personi përgjegjës deri në pjesën e tunelit ku bëhej dalja e saj.

5 Shtetasi D.D. u pozicionua në fillim të dishezës që të çonte tek tuneli, ndërsa shtetasi S.N. dhe R.F. hynë në tunel në drejtim të vendit ku do të merrnin në dorëzim shumën e parave. R., duke patur dijeni për sasinë prej katër thasësh, i kërkoi S. të thërriste T.H. , i ndodhur në atë moment në makinën e ekskortës. Pas thirrjes dhe mbërritjes së T. ky dhe S. u pozicionuan tek qepeni i vendosur në hyrje të tunelit. Pas hapjes së qepenit, R. mori në dorëzim vlerat monetare, duke mbajtur dy thasë vetë ndërsa dy të tjerët ia dha T. dhe filluan lëvizjen. T. eci i pari, pas tij R.dhe në fundë S.N. .

6 Gjatë lëvizjes në tunel, I.S. i doli përpara T. , ndërsa D. ndodhej para tyre. Në moment tre persona të armatosur dhe me maska dolën me të shpejtë nga vendi perballë qepenit dhe u vunë në ndjekje të tyre. R. , që në atë kohe kishte mbërritur në hyrje të tunelit, dëgjoi nga mbrapa një thirrje për të vendosur thasët në tokë. Ktheu kokën dhe pa një person të armatosur, i cili qëlloi një herë të vetme në drejtim të dyshemesë. La thasët në tokë, ndërsa D. me të parë personin e armatosur u largua me vrap. Personi tjetër i armatosur dhe me maska goditi lehtë në fytyrë Sajmirin dhe, pasi doli nga tuneli, urdhëroi I.S. të hidhte armën automatik në tokë, ndërsa u dëgjua një krismë. Personi i tretë me maskë i dalë nga tuneli mori armën e S. i cili u largua dhe ju drejtua T.H. , që lëshoi thasët në tokë dhe e urdhëroi të ndizte makinën. Personi qëlloi një here të vetme. Së bashku me katër thasët, me mjetin e eskortës, ata u larguan. Mjeti i braktisur u gjet, më vonë, në rrugën "Sulejman Vathi", Tiranë.

7. Fakti i dytë penal objekt akuze, rezulton të ketë ndodhur në këto rrethana: Mëngjesin e datës 3.12.2015, E.H., Drejtore e Departamentit të Thesarit në Bankën "Credins" dhe L. M., specialist i këtij Departamenti, vendosën të kryenin dërgesën e një fondi të përbërë prej 1 800 000 Paund Britanik, 800 000 Dollarë Amerikanë, 200 000 Dollarë Kanadezë dhe 200 000 Dollarë Australianë, Bankës "Raiffesien", Vjenë, Austri. Ndërsa u urdhërua përgatitja e fondit, L. komunikoi me I.P. , Përgjegjës i Sektorit të Sigurisë së Bankës, që të koordinonte punën me Shoqërinë e Sigurimit "Rogat" për kryerjen e transportit për në Rinas.

8 Rreth orës 13:00, mjeti i blinduar i Shoqërisë së Sigurimit "Rogat", me targa xx xxxx x, me drejtues A.A. dhe pasagjer I.P., pas marrjes, në Thesarin Qëndror, të ndodhur në "Veve Center", të sasisë së parave të paketuara në dhjetë thasë, u nis në drejtim të

Rinasit. Ai shoqërohej nga makina e eskortës, "Benz Mercedes", me targa xx xxx xx, në të cilin ndodheshin A.Sh., E.M., N.P. dhe A.Ll. .

9. Gjatë udhëtimit në drejtim të Rinasit, poshtë Qafë Kasharit, në kryqëzimin ndërmjet rrugëve të fshatrave Bërxull, Domje dhe Laknas, mjetit të blinduar ju pre rruga nga një fuoristradë, me ngjyrë ulliri, me fenelinë policie dhe xhama të zinj. Personat e zbritur nga mjeti, të maskuar, të armatosur, të veshur me uniformë policie, qëlluan me armë dhe, me ndihmën e një varreje, çanë xhamin e blindit dhe hapën derën. Personat e armatosur morën sasinë e parave të ndodhur në blind dhe u larguan. Mjeti me të cilin u larguan u gjet i djegur, pak kohë më pas, pranë urës së Limuthit.

10. Fakti i tretë penal objekt akuze, rezulton të ketë ndodhur në këto rrethana: Në datë 9.2.2017, F.P., Drejtues i Departamentit të Thesarit në BKT, përballë ETC, së bashku me S.Sh., asistentë drejtuese e këtij Departamenti si dhe, B.B., punonjëse e Drejtorisë Qëndrore, vendosën të kryenin transport dërgesash monetare për në Rinas, në shumën 2 400 000 (dymilion e katërqind mijë) Euro, 200 000 Dollarë Amerikanë, 260 000 Paund Britanik, 85 000 Franga Zvicëranë, 30 000 Dollarë Australianë dhe 30 000 Dollarë Kanadezë, e paketuar në tetë thasë.

11. Rreth orës 10:00, Fatmir Gapi, drejtues teknik i shoqërisë SH.R.S.F "Jaguar Security", u njoftua nga Departamenti i Thesarit të BKT për transfertën që do të kryhej. I kërkoi A.H., përgjegjës ekskorte i Shoqërisë, që ekskorta të paraqitej në Drejtorinë e BKT, në orën 12:30. Rreth orës 12:45, dy mjetet e blinduara të shoqërisë së sigurimit, njëri i markës "Ford" minifurgon, me targa xx xxxx x, me drejtues D.B. dhe pasagjer G.D. dhe tjetri "Ford", me targa xx xxxx x, me drejtues E.D. dhe shoqërues dhe P.L., mbërritën tek dera e thesarit. Pas vendosjes së sasisë në kasafortë, dy mjetet udhëtuan në drejtim të Rinasit.

12. Gjatë rrugës, para se të mbërrinin tek Universiteti "Epoka", nga një rrugë dytësore, doli mjeti "Jeep", me xhama të zinj, i cili u përplas me mjetin e parë të eskortës, të drejtuar nga D.B. . Nga mjeti "Jeep" dhe nga një mjet tjetër, fuoristradë, zbritën persona të armatosur, të veshur me uniforma policie dhe me maska. Ata qëlluan me armë, goditën me varre xhamin e blindit dhe, me një gur fresibël, hapën kasafortën e morrën paratë. Ata u larguan me mjetet e tyre, të cilët u gjetën të djegur, ditën e ngjarjes, në fshatin Gjec-Fushë.

13. Në datë 13.3.2018, me arsyetimin se hetimet, në ngarkim të të pandehurve A. M., D.K., E.K., N.A., F.Xh., D.M., A.Q., D.S. dhe A.M., ishin të plota dhe se çështja duhej të dërgohej në gjykim, ndërsa duhej të hetohej për bashkëpunëtorë të tjerë të mundshëm, bazuar në nenin 93 pika 1 gërma "ç" e Kodit të Procedurës Penale, u vendos ndarja e procedimit penal nr. 63/2017 në dy procedime më vete, Nr. 63/1 në ngarkim të të pandehurve për të cilët është kërkuar dërgimi në gjyq i çështjes penale në ngarkim të tyre dhe, në nr. 63/2017 në ngarkim

të personave të tjerë të paidenfikuar, pjesë e grupit të strukturuar kriminal, për hetime të mëtejshme dhe kërkesa për dërgimin në gjyq u pranua nga Gjykata e seancës paraprake sipas vendimit nr. 43 datë 24.4.2018 të Gjykatës së Shkallës së parë për Krime të rënda.

14. Në bazë të neneve 3 dhe 24 sipas ligjit nr. 10192, datë 03.12.2009 “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, rezulton se, shtetasit A.M., A.M., si dhe familjarët e tyre janë subjekte për kryerjen e verifikimeve pasurore. Gjatë hetimit penal janë kryer verifikime, jo vetëm për subjektet A.M.dhe A.(Sh.) M. por edhe për familjarët e tij, e më konkretisht ndaj këtyre shtetasve:

- T.M., atësia Sh. dhe amësia M., lindur më xx.x.xxxx në Margegaj, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- A.M., atësia S. dhe amësia B., lindur më x.x.xxxx (xx.xx.xxxx) në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- S.M., atësia A. dhe amësia T., lindur më x.xx.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- M.M., atësia A. dhe amësia T., lindur më xx.xx.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- N.M., atësia A. dhe amësia T., lindur më x.x.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- B.M., atësia Azem dhe amësia Tale, lindur më xx.x.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- I.(C.) M., atësia A. dhe amësia T., lindur më xx.xx.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- F.(A.) M. (N.), atësia A. dhe amësia T., lindur më x.x.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- Sh. (A.) M., atësia A. dhe amësia T., lindur më xx.x.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- A.M., atësia A. dhe amësia T., lindur më x.x.xxxx në Qerem, Tropojë dhe banues në Tropojë.
- A.A., (A., M.), atësia H. dhe amësia H., lindur më xx.x.xxxx në Kalas, Delvinë dhe banues në Delvinë.
- N.A., atësia H. dhe amësia H., lindur më x.x.xxxx në Kalas, Delvinë dhe banues në Delvinë.
- V.A., atësia H. dhe amësia H., lindur më xx.xx.xxxx në Kalas, Delvinë dhe banues në Delvinë.

15. Me shkresën Nr. 17/27339 Prot, datë 30.05.2017, Intesa SanPaolo Bank njofton se, shtetasi C.M. ka patur llogari në Euro pranë kësaj banke me bazë 490107. Ky shtetas me datë 20.5.2009 ka derdhur në llogarinë e tij shumën prej 500.000 (pesëqind mijë) euro dhe e ka transferuar në bankën Credins me datë 29.01.2013. Është dërguar shkresë Zyrës Kombëtare të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Qendrore dhe atyre në nivel lokal për pasuritë që zotërojnë shtetasit e mësipërm ku rezulton se :

Për shtetasin A.M. ka pasuri të regjistruar në ZVRPP Tiranë:

- Zona kadastrale 2183, vol 7, faqe 46, garazh me sip. 23 m2, dala e leshimit të çertifikatës 12.4.2016, blerë me kontratën e shitblerjess nr.387 rep 203 kol. datë 26.3.2016 nga shoqëria “Al-Konstruksion” me përfaqësues ligjor shtetasi B.I., në vlerën 4.000 USD.

- Zona kadastrale 2183, vol 7, faqe 146, apartament me sip. 100.5 m2. Kjo pasuri është blerë nga shoqëria “Al-Konstruksion” me përfaqësues ligjor shtetasi B.I. me kontratën e shitblerjess nr.386 rep 202 kol. Datë 26.03.2016, për shumën 41.740 dollarë.

16. Shtetasi Sh.M.(A.M.) ka në pronësi, ZK.3866, Nr. Pasurisë 312/202, Vol.57, Fq.95, lloji i pasurisë truall, Sip.473.50 m2. fituar me kontratën nr.2774 rep. Nr.928 kol. datë 3.6.2008, në shumën 2.998.500 lekë., kjo pasuri gjendet me adresë Yzberisht, Tiranë dhe është regjistruar në vitin 07.05.2012.

17. Në emër të shtetasit A.M. figuron e regjistruar pasuria ZK.3049, vol.2, faqe 37, truall me sipërfaqe 300 m2 dhe ndërtesë me sip.65 m2., kjo pasuri është blerë nga shtetasi D.C. me kontratën nr. 2774 rep., nr. 828 kol. datë 3. 6.2008 për shumën 2.379.000 lekë.

18. Për shtetasen A.A., bashkëjetuesja e shtetasit A.M., ZVRPP Tiranë, me shkresën Nr. 21621/1 Prot, datë 7.11.2017, me lëndë “kthim përgjigje” informon se, shtetësja A.A. ka pasuri në ZK.2704, Nr. Pasurisë 474/7, Vol.21, Fq. 59, lloji i pasurisë pemtore, Sip. 608 m2. Kjo pasuri është regjistruar në vitin 2013. Kjo pasuri është regjistruar me kontratën nr.1823 kol nr.363 rep. Datë 05.04.2013, në vlerën 1.200.000 lekë.

19. ZVRPP Sarandë, me shkresën Nr.6799/1 Prot, datë 19.06.2017 njofton se shtetasi A.A. ka të regjistruar pasurinë si më poshtë: Në zonën kadastrale të qytetit Sarandë 8641-8642, pasuri e llojit apartament me sipërfaqe 71 m2, volum 17, faqe 28. Ky apartament është blerë nga shoqëria Tulo shpk, me kontraten nr.265 rep nr.52/1 kol në vitin 13.01.2013, tek noteri Genc Nikolla, në shumën 3.698.316 lekë. Në këtë kontratë sipas prokurës së posaçme datë 12.01.2013, kjo shtetase është përfaqësuar nga shtetasi A.A.M. .

20. Shtetasi N.M. ka në pronësi, ZK.3866, Nr.Pasurisë 363/16+1-37, Vol.97, Fq.21, lloji i pasurisë Apartament, Sip.57.40 m2. Kjo pasuri gjendet me adresë Yzberisht, Tiranë dhe është regjistruar në datë 04.09.2015, në shumën 34.900 euro, me barrë hipotekore.

21. ZVRPP Tropojë, me shkresën Nr.376/Prot, datë 06.04.2017 njofton se shtetasi A.M. ka të regjistruar pasuritë:

- Pasuri me Nr.66/2, V1, F67, Arë 400 m2.

- Pasuri me Nr.67, V1, F68, Arë 600 m2.

- Pasuri me Nr.128, V1, F69, Truall 300 m2.

Këto pasuri janë fituar me ligjijn Nr.7501 dhe janë regjistruar në vitin 2002.

22. ZVRPP Tropojë, me shkresën Nr.3436/Prot, datë 13.06.2017 njofton se shtetasi A.M. ka të regjistruar pasurinë si më poshtë:

ZK 1370 Çerem.

- Pasuri Nr. 65, V 1, F 66 llojit Arë, sip. 600 m2.

- Pasuri Nr. 66/1, V 1, F 63 llojit Arë, sip. 500 m2.

- Pasuri Nr. 63, V 1, F 64 llojit Arë, sip. 200 m2.

Këto pasuri janë fituar me ligjin Nr.7501 dhe janë regjistruar në vitin 2002.

- Pasuri Nr. 40/7, V 7, F 91, llojit Arë, sip.2500 m2, regjistruar me kontratë shitblerje në vitin 2003.

- Pasuri Nr. 4/24+1-10, V 5, F 181, llojit Apartament, sipërfaqe 81 m2, regjistruar në vitin 2011 me kontratë shitblerje

23. Në emër të shtetasit S.M. janë të regjistruara në ZK 1347 B.Curri, pasuritë e mëposhtme:

- Pasuri Nr. 6/96, V 9, F 60, lloji njësi + truall me sip.99.75 m2. Njësia e regjistruar në vitin 2003 dhe trualli në vitin 2005 me kontratë shitblerje.

- Pasuri Nr. 6/4/1, V 9 , F 99, llojit truall me sipërfaqe 211 m2, regjistruar në vitin 2013 me kontratë shitblerje.

- Pasuri Nr. 6/9/1, V 10, F 9, llojit ndërtesë me sip.99.75 m2 (dy kate), regjistruar në vitin 2009 me leje ndërtimi.

- Pasuri nr. 6/4/1N, V 11, F 93, lloji ndërtesë, sip. 151 m2 (godinë tre kate + bodrum) e regjistruar si karabina në vitin 2015 me leje ndërtimi.

24. Drejtoria e Policisë së Shtetit me shkresën Nr.2418/19 prot datë 10.05.2017 jep të dhëna e mëposhtme;

- Shtetasi A.M. ka në pronësi apartament banimi + garazh në Vorë, tek pallati I., si dhe ka në posedim disa automjete për të cilat janë duke punuar për identifikimin dhe pronësinë e tyre si dhe ka pronotuar në zonën e freskut Tiranë, katër apartamente.

Po kështu, shtetasi C.M. ka një servis automjetesh në Vorë, brenda këtij servisi ka edhe një lokal dhe karburantin “S Petrol” në Vorë, si dhe një apartament në rrugën “Sami Frashëri”, Tiranë.

25. Gjithashtu gjatë verifikimeve të kryera ka rezultuar se shtetasi C.M. ka nënshkruar deklarata noteriale si më poshtë vijon: në datë 17.5.2014 ka nënshkruar një deklaratë noteriale me shtetasin F.K. sipas të cilës njihet detyrimi në shumën 150.000 EURO, sipas deklaratës Nr. rep,1477, Nr.kol,397, të nënshkruar para noter Dhimitra Qarri.

Në datë 17.5.2014 ka nënshkruar deklaratë noteriale me shtetasin G.C., sipas së cilës njihet detyrimi në shumën 200.000 EUR, sipas deklaratës Nr. rep.1478 dhe Nr. kol .398, të nënshkruara përpara noterit Dhimitra Qarri. Në datë 28.04.2010 ka mbyllur depozitë me afat pranë bankës Alpha, në shumën 80.000 EUR. Në datë 18.11.2011 ka përfituar nga DPRRR për shpronësim sipas VKM 665, dt.28.09.2011, pranë bankës Credins, shumën 9.390.999 LEK. në datë 23.11.2011 ka tërhequr pranë bankës Credins, shumën 1.000.000 LEK. Në datën 30.11.2011 ka tërhequr pranë bankës Credins, shumën 500.000 LEK.

26. Në datën 2.12.2011 ka tërhequr pranë bankës Credins, shumën 5.600.000 LEK. Në datën 07.01.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT, shumën 1.000.000 LEK. Në datën 08.01.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT, shumën 3.200.000 LEK. Në datën 07.04.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT, shumën 3.820.000 LEK. në datën 21.03.2016 A.M. ka kredituar llogarinë pranë bankës Tirana, në shumën 45.740 USD, me përshkrim “Nga shpronësim i pronës”. Gjithashtu shtetasi A.M. ka në pronësi mjetet me targa xx xxx xx dhe xx xxx xx.

27. Drejtoria e Policisë së Shtetit me shkresën Nr. 2671/2 prot datë 10.05.2017 jep të dhëna e mëposhtme;

- Shtetasi A.N. (M.) ka në pronësi një banesë dy katëshe në Prezë, Tiranë si dhe dy mjete të markave Mercedes Benz dhe Toyota. Në rrugë operative është mësuar se ish-bashkëshortja e tij A.A. ka blerë një apartament në rrugën “Mihal Grameno”, Tiranë në vlerën 185.000 EURO, si dhe posedon edhe pasuri të tjera që nuk janë të regjistruara në emrin e tyre.

- Shtetësja A.A. është e ndare nga ana procedurale nga shtetasi A.M. por jeton së bashku me bashkeshortin e tij A.M. . Kjo shtetase ka lidhur disa kontrata për prenotim apartamentesh, si dhe ka një vilë tre katëshe në zonën e ish repartit 3700.

- Me datë 5.4.2013 shtetësja A.A. ka blerë nga shtetasi I.K. pentore me sipërfaqe 608 m2 në Mjull, Bathore, Tiranë, kundrejt shumës 1.200.000 LEK, sipas kontratës me Nr.rep.1823, Nr.kol.363 të nënshkruar përpara noteres Ardjana Mehdi-Hoxha.

- Në datë 5.7.2012 ka porositur tek shoqëria “Tulo” shpk për ndërtim apartament banimi i ndodhur në Sarandë, zona turizëm, Kanali i Çukës, kundrejt shumës 90.000 EURO, sipas kontratës së porosisë Nr.rep.3283, Nr.kol.1156, të nënshkruara përpara noter Genci Nikolla.

- Në datë 12.6.2014, ka derdhur për transfertë me jashtë, pranë BKT, shumën 34.000 EUR.

- Në datë 19.8.2016 ka derdhur në favor të “Bregu” sha, për porosi blerje objekti, pranë BKT, shumën 57.000 EUR.

- Në datë 30.9.2016 ka kredituar llogarinë pranë bankës Tirana, në shumën 2.530 USD.

- Me datë 17.08.2015 ka derdhur në llogari të saj pranë BKT, shumën 10.00 GBP me përshkrimin “për garanci studimi në Angli”, burimi i deklaruar i të ardhurave “nga emigracioni”.

28. Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë me shkresën Nr. 781/K-1 prot datë 5.6.2017 jep të dhëna e mëposhtme; Vila dy katëshe e ndodhur në fshatin Prezë, Vorë është në pronësi të shtetasit A.M. (N.) e blerë nga shtetasi D.C.. Aktualisht në këtë banesë nuk banon asnjëri dhe herë pas here shkon bashkëshortja e shtetasit A.M. e cila bën pastrimin e kësaj ndërtese.

29. Ujësjellës Kanalizime, Tiranë me shkresën Nr. K-1132/1 Prot, datë 13.6.2017 kthim

A.M. ka kontratë me numër XXXXXXXXXXXXXXX me adresë Vorë, pall.2, ap.24. Shtetësja A.A. ka kontratë me numër XXXXXXXXXXXXXXX, me adresë Sarandë, Butrinti, pall.0, shk.0, ap.0.

33. DPSHT Rrugor, me shkresën Nr. 2886 Prot, datë 9.6.2017 njofton se, shtetasi N.A. ka në pronësi mjetet me targa xx xxx xx dhe xx xxx xx. Mjeti me targë xx xxx xx është mjet i tipit Toyota, viti i prodhimit 2001, impotuar nga Greqia. Mjeti me tragë xx xxx xx, është tip Toyota, viti i prodhimit 2006. Ky mjet është blerë më datë 28.5.2013 nga subjekti Economy Motors shpk për shumën 7.000 USD.

34. Shtetasi I.(C.) M. ka në pronësi mjetin me targa xx xxxx xx. Mjeti është i markës Citroen Xsara, viti i prodhimit 2001 dhe është blerë me datë 4.12.2013 nga shoqëria ERD, me seli në Vlorë për shumën 250.000 LEK. Po ashtu, ku shtetas ka në pronësi automjetin me targë xx xxx xx, i markës Audi A 6, viti i prodhimit 2000 dhe është blerë në vitin 2013 nga shtetasi S.D., për shumën 1.000 EUR; automjetin me targë xx xxx xx, i markës Fiat, viti i prodhimit 1999 dhe është blerë në datë 17.03.2016 nga shtetasi R.H. për shumën 200.000 LEK; automjetin me targë xx xxx xx, i markës Dodge Durango, viti i prodhimit 2006 dhe është blerë në datë 10.10.2013 nga shtetasi M.K. për shumën 3.500 EURO; mjetin me targë xx xxx, i tipit motorr, i markës BMË, viti i prodhimit 2016 dhe është blerë në datë 19.05.2016 nga subjekti tregtar Lejeune Motosport Verviers, për shumën 19.363 EURO; mjetin me targë xx xxx, i tipit motorr, i markës Yamaha, viti i prodhimit 2005 dhe është blerë në datë 04.05.2016 nga subjekti tregtar Rich Vermeersch, për shumën 1.500 EURO; automjetin me targë xxx xxx, rimorkio për transport mallrash, viti i prodhimit 2005 dhe është blerë në datë 20.05.2016 nga shtetasi Z.G. për shumën 150 EURO; automjetin me targë xx xxx, rimorkio për transport të veçantë, viti i prodhimit 2000 dhe është blerë në datë 19.05.2016 nga shtetasi Z.G. për shumën 150 EURO.

35. DPSHT Rrugor me shkresën Nr. 3802/2 Prot, datë 31.3.2017 njofton se, shtetasi A. M. ka në pronësi mjetin me targa xx xxx xx, i markës BMË, viti i prodhimit 2004 dhe është blerë me datë 6.5.2015 nga shtetasi A.M. për shumën 400.000 LEK. Shtetasi I.(C.) M. ka në pronësi mjetin me targa xxx xxx, i markës Carosino gjysëmrimorkio, viti i prodhimit 1997 dhe është blerë me datë 23.03.2015 nga shtetasi N.Z. për shumën 507.600 LEK; mjetin me targa xx xxx xx, i markës Ford, viti i prodhimit 1999 dhe është blerë me datë 10.03.2016 nga shtetasi L.S. për shumën 1.500 EURO; mjetin me targa xx xxx xx, i markës Fiat, viti i prodhimit 1999 dhe është blerë me datë 17.3.2016 nga shtetasi R.H. për shumën 200.000 LEK; si dhe mjetin me targa xx xxx xx, i markës Dodge, viti i prodhimit 2007 dhe është blerë me datë 18.05.2016 nga shtetasi V.E. për shumën 3.500 EUR.

36. DPSHT Rrugor me shkresën Nr. 1709/1 Prot, datë 5.6.2017 njofton se, shtetasi N.M. ka në pronësi mjetin me targa xx xxxx x, i markës JEEP, viti i prodhimit 1996 dhe është blerë me datë 11.10.2006 nga shtetasi A.I. për shumën 2.000 EURO dhe mjetin me targa xx xxxx x, i markës Benz kamion, viti i prodhimit 1990 dhe është blerë me

datë 18.06.2007 nga shtetasi A.L. për shumën 250.000 LEK.

37. Drejtoria e Përgjithsme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, me shkresën Nr.379 Prot, datë 17.02.2017, me lëndë “kthim përgjigje”, informon se, I.M. me datë 1.10.2014 ka tërhequr pranë BKT, shumën 14.960 GBP, me burim të deklaruar të ardhurave “nga emigracioni” për përdorim shkollimi jashtë. Në datën 17.08.2015, A.A. ka derdhur në llogari të saj pranë BKT shumën 10.000 GBP, me përshkrim “për garanci studimi në Angli”, burimi i deklaruar i të ardhurave “nga emigracioni”. Shtetësja A.M. (A.) ka blerë nga shtetasi I.K. pemtore me sip.608 m2, të ndodhur në Mjull Bathore, Tiranë, kundrejt shumës së deklaruar 1.200.000 Lek, sipas kontrates nr.rep.1823, nr.kol.363 të nënshkruar para noterit Ardjana Mehdi Hoxha.

38. Në datë 5.7.2012, shtetasja A.A. porositi shoqërinë “Tulo” shpk për ndërtim apartamenti banimi i ndodhur në Sarandë, zona Turizëm Kanali i Çukës, kundrejt shumës 90.000 euro, sipas kontratës së porosisë nr. rep.3283, nr. kol.1156 nënshkruar përpara noterit Genci Nikolla. Në dtë 13.01.2013, kjo shtetase blen pranë shoqërisë “Tulo” shpk apartament i ndodhur në Sarandë zona Turizëm Kanali i Çukës, kundrejt shumës 3.698.716 Lek, sipas kontratës nr. rep.205, nr. kol.52, nënshkruar përpara noterit Genci Nikolla. Në datë 12.6.2014 ka derdhur për transfertë më jashtë pranë BKT, shumën 34.000 Euro. Në datë 19.8.2016 derdhur në favor të “Bregu” sha për porosi blerje objekti, pranë BKT shumën 57.000 Euro. Në datën 30.9.2016, ka kredituar llogarinë, pranë bankës Tirana, në shumën 2.530 USD.

39. Shtetasi C.M. në datë 17.5.2014 ka nënshkruar deklaratë noteriale me shtetasin F.K. sipas së cilës njihet detyrimi në shumën 150.000 Euro, sipas deklaratës noteriale nr.rep.1477, nr.kol.397 të nënshkruar përpara noterit Dhimitra Qarri. Me datë 17.5.2014, ky shtetas ka nënshkruar deklaratë noteriale me shtetasin G.C. sipas së cilës njihet detyrimi në shumën 200.000 euro, sipas deklaratës nr. rep.1478, nr. kol.398 të nënshkruar përpara noterit Dhimitra Qarri. Në datë 28.4.2010 ka mbyllur depozitën me afat pranë bankës Alpha, në shumën 80.000 Euro. Në datë 18.11.2011 ka përfutur nga shpronësimi sipas VKM 665, dt. 28.9.2011, pranë bankës Credins shumën 9.390.999 lek. Në datë 23.11.2011 ka tërhequr pranë bankës Credins shumën 1.000.000 lek. Në datën 30.11.2011 ka tërhequr pranë bankës Credins shumën 500.000 lek. Në datën 2.12.2011, ka tërhequr pranë bankës redins shumën 5.600.000 lek. Në datë 8.1.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT shumën 1.000.000 lek. Në datë 8.1.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT shumën 3.200.000 lek. Në datë 7.4.2014 ka tërhequr pranë bankës BKT shumën 3.820.000 lek. Në datën 21.3.2016 shtetasi A.M. ka kredituar llogarinë pranë bankës Tirana në shumën 45.740 USD me përshkrim “nga shpronësimi i pronës”. Shtetasi C.M. është hetuar si person i lidhur me shtetasin A. dhe S.Sh. , ku dhe është nxjerrë një urdhër bllokimi për shumën 2.6 miljon euro. Prokuroria ka vendosur konfiskimin e fondeve.

40. Përveç sa më sipër, shtetasve A.M., C.M., A.M. u janë sekuestruar në kuadër të procedimit penal pasuritë e mëposhtme:

- Automjet i llojit BMË X6, me targa xxxxxx, sekuestruar shtetasit C.M.
- Automjet i llojit Fouristrade Mercedes Benz;
- Automjeti fuoristrade BMË X3, me targa xxx xxxxxx xx sekuestruar të pandehurit A.M.;
- Automjet i markës DODGE, me targa xx xxxx xx, sekuestruar shtetasit C.M.
- Automjet i markës DODGE me targa xx xxxxxx, sekuestruar shtetasit C.M.;
- Automjet i markës Mitsubishi, ngjyrë gri, pa targa, sekuestruar shtetasit C.M.
- Automjet i markës Volsëagen Tiguan me targa xx xxx xx, sekuestruar shtetasit C.M.;
- Automjeti I markës land rover model defender me targa xx-xxx- xx sekuestruar C.M.; datë 14.02.2017
- Një motocikletë, tip BMË, model R1200 me targë xx-xxx, sekuestruar në banesën e A.M., celësat dorëzuar nga C.M. ;

41. Rrethana të tilla të faktit provohen me këto akte dhe prova:

- Urdhër për regjistrimin e Procedimit Pasuror Nr. 2, datë 04.3.2019.
- Shkresa nr. 1904, Prot, datë 29.5.2017, drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile, Njësia Bashkiake nr.5, Tiranë.
- Shkresa nr. 1975/1, Prot, datë 12.6.2017, ardhur nga Njësia Bashkiake nr. 5 Tiranë, së bashku me aktet bashkëlidhur saj.
- Shkresa nr. 1786 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Alpha Bank” sha.
- Shkresat nr. 11586 Prot, datë 10.4.2017 dhe nr. 20706 Prot, datë 02.07.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Alpha Bank” sha.
- Shkresa Nr. 1787 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Credins Bank” sha.
- Shkresat Nr. 15043/1 Prot, datë 30.3.2017 dhe Nr. 26816/1 Prot, datë 05.06.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Credins Bank” sha.
- Shkresa Nr. 1792 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Intesa Sanpaolo Bank” sha.
- Shkresat Nr. 17/15016/1 Prot, datë 27.3.2017 dhe Nr. 17/273339 Prot, datë 30.05.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Intesa Sanpaolo Bank” sha.
- Shkresa Nr. 1794 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Banka Kombëtare Tregtare” sha.
- Shkresa Nr. 19517 Prot, datë 23.6.2017 të ardhur nga Institucioni financiar bankar “Banka Kombëtare Tregtare” sha.
- Shkresa Nr. 1789 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “NBG Albania” sha.
- Shkresat Nr. 009641 Prot, datë 24.3.2017 dhe Nr. 017755 Prot, datë 29.05.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “NBG Albania” sha.
- Shkresa Nr. 1790 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Societe Generale Albania” sha.
- Shkresa Nr. 17/08306/tbo-002 Prot, datë 5.6.2017 dhe Nr. 17/04309/tbo-002, datë

- 28.03.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Societe Generale Albania” sha.
- Shkresa Nr. 1791 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Abi bank” sha.
 - Shkresat Nr. 5530/1 Prot, datë 31.5.2017 dhe Nr. 3726, datë 14.04.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Abi bank” sha.
 - Shkresa Nr. 1793 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “FiBank” sha.
 - Shkresat Nr. ON-A-18486/2017 Prot, datë 1.6.2017 dhe Nr. ON-A-9710/2017, datë 27.03.2017 të ardhura nga Institucioni financiar bankar “FiBank” sha.
 - Shkresa Nr. 1788 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “UBA Bank” sha.
 - Shkresat Nr. 15725 Prot, datë 1.6.2017 dhe Nr. 8546/17, datë 28.3.2017 të ardhura nga Institucioni financiar bankar “UBA Bank” sha.
 - Shkresa Nr. 1802 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “ICB Bank” sha.
 - Shkresat Nr. 4640/1 Prot, datë 1.6.2017 dhe Nr. 2609 Prot, datë 29.3.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “ICB Bank” sha.
 - Shkresa Nr. 1800 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Veneto Banka” sha.
 - Shkresat Nr. 20246/1 Prot, datë 30.5.2017 dhe Nr. 10828/1 Prot, datë 27.3.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Veneto Banka” sha.
 - Shkresa Nr. 1795 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Banka Shqiptare e Kreditit” sha.
 - Shresa Nr. 6127/2017 Prot, datë 25.5.2017 të ardhur nga Institucioni financiar bankar “Banka Shqiptare e Kreditit” sha.
 - Shkresa Nr. 1796 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “ProCredit Bank” sha.
 - Shkresat Nr. 4412 Prot, datë 1.6.2017 dhe Nr. 2708 Prot, datë 27.3.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “ProCredit Bank” sha.
 - Shkresa Nr. 1797 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Raiffeisen Bank” sha.
 - Shresat Nr. 19866 Prot, datë 6.6.2017 dhe Nr. 10944/1 Prot, datë 24.3.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Raiffeisen Bank” sha.
 - Shkresa Nr. 1798 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institucionit financiar bankar “Tirana Bank” sha.
 - Shkresat Nr. 10174 Prot, datë 2.6.2017 dhe Nr. 6209 Prot, datë 30.3.2017, të ardhura nga Institucioni financiar bankar “Tirana Bank” sha.
 - Shkresat Nr. 716 Prot, datë 23.3.2017 dhe Nr. 1801 Prot, datë 25.5.2017 drejtuar Institucionit Qëndror Bankar Banka e Shqipërisë.
 - Shkresat Nr. 2343/1 Prot, datë 31.5.2017 dhe Nr. 1208/1 Prot, datë 28.3.2017, të ardhura nga Institucioni Bankar Banka e Shqipërisë.
 - Shkresa nr. 1783 Prot, datë 25.5.2017 drejtuar Zyrës Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë.
 - Shkresa nr. 21621/1 Prot, datë 7.11.2017 “kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP, Tiranë, së bashku me praktikën bashkëlidhur saj.
 - Shkresa nr. 11094 Prot, datë 4.7.2017 “kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP, Tiranë, së bashku me praktikën bashkëlidhur saj.
 - Shkresa nr. 19831 Prot, datë 3.7.2017 “kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP, Tiranë, së bashku me praktikën bashkëlidhur saj.
 - Shkresa nr. 376/1 Prot, datë 6.4.2017, “Kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP B.Curri.

- Shkresa nr. 3264 Prot, datë 1.6.2017, “Kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP Tropojë.
- Shkresa nr. 6799/1 Prot, datë 19.6.2017, “Kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP Sarandë, së bashku me praktikën bashkëlidhur saj.
- Shkresa nr. 4797 Prot, datë 16.2.2017, “kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP Tiranë, së bashku me aktet bashkëlidhur saj.
- Shkresa nr. 7629/1 Prot, datë 4.8.2017, “Kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP Lushnjë.
- Shkresa nr. 2236/1 Prot, datë 13.7.2017, “Kthim përgjigje”, ardhur nga ZVRPP Lezhë.
- Shkresa nr. 1774 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, Tiranë.
- Shkresa nr. 12223/1 Prot, datë 3.8.2017, ardhur nga DPT, Drejtoria e Hetimit Tatimor, Tiranë së bashku me praktikën përkatëse.
- Shkresa nr. 1784/1 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Drejtorisë së Ujësjetës Kanalizimeve Tiranë.
- Shkresa nr. K-1132/1 prot, datë 13.6.2017, ardhur nga Drejtoria e UKT-së, Departamenti i Shitjes, së bashku me aktet bashkëlidhur saj.
- Shkresa nr. 1681 prot, datë 22.5.2017, drejtuar DVP Tiranë, Postës së Policisë Vorë.
- Shkresa nr. 781 Prot, datë 5.6.2017 “Kthim përgjigje”, ardhur nga Komisariati i Policisë Vorë.
- Shkresa nr. 1770 prot, datë 25.5.2017, drejtuar Institutit të Sigurimeve Shoqërore Tiranë.
- Shkresa nr. 4863 Prot, datë 31.5.2017 “Kthim përgjigje”, ardhur nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore së bashku me praktikën bashkëlidhur saj.
- Shkresa nr. 1775 prot, datë 25.5.2017, drejtuar Bashkisë Tropojë.
- Shkresa nr. 2545 Prot, datë 15.6.2017 “Kthim përgjigje”, ardhur nga Bashkia Tropojë, së bashku me aktet shoqëruese të saj.
- Shkresa nr. 1776 Prot, datë 25.5.2017 drejtuar, Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave dhe Tarifave Vendore, Tiranë.
- Shkresa nr. 129940/1 Prot, datë 1.6.2017 ardhur nga DPTTV, Bashkia Tiranë.
- Shkresa nr. 1768 prot, datë 25.5.2017, drejtuar OSHEE, Tiranë.
- Shkresa nr. 13699 Prot, datë 2.6.2017 ardhur nga OSHEE, Tiranë, së bashku me praktikën shkresore bashkëlidhur përgjigjes.
- Shkresa nr. 1779 prot, datë 25.5.2017 dërguar Qendrës Kombëtare të Licencimit.
- Shkresa nr. 7747, datë 5.6.2017 “Kthim përgjigje” ardhur nga QKB-ja, Tiranë.
- Shkresa nr. 1777 Prot, datë 25.5.2017, drejtuar Agjencisë së Trajtimit të Pronave.
- Shkresa nr. 5411 prot, datë 1.6.2017 “Kthim përgjigje” ardhur nga ATP, Tiranë.
- Shkresës nr. 1780, prot, datë 25.5.2017, drejtuar Zyrës Kombëtare të Punësimit, Tiranë.
- Shkresa nr. 67 prot, datë 1.6.2017 “kthim përgjigje” ardhur nga SHK Punësimit.
- Shkresa nr. 1773 prot, datë 25.05.2017 drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave.
- Shkresa nr. 12879 prot, datë 19.6.2017 “Kthim përgjigje” ardhur nga DP Doganave.
- Shkresa nr. 1778 prot, datë 25.5.2017 drejtuar Agjencisë së ALUIZN-it.
- Shkresa nr. 3837 prot, datë 6.6.2017 “Kthim përgjigje” ardhur nga Agjencia e ALUZIN-it, Tiranë.
- Shkresa nr. 1682 Prot, datë 22.5.2017 drejtuar Zyrës së Urbanistikës pranë Bashkisë Vorë.
- Shkresa nr. 2579, datë 20.6.2017 “kthim përgjigje ardhur nga Bashkia Vorë.
- Materiali Kallëzues “Për fillimin e procedimit penal për disa shtetas”, referuar nga Drejtoria e Vendore e Policisë Tiranë, përmes shkresës nr. 6056 Prot, datë 17.3.2017, së bashku me aktet procedurale përkatëse.
- Shkresa nr. 2351 prot, datë 11.04.2017, “Për dërgimin e dokumentave”, ardhur nga Drejtoria e përgjithshme e Gjendjes Civile.
- Shkresa nr. 2671/2 prot, datë 10.5.2017, “Dërgohet informacion pasuror për disa shtetas”

ardhur nga DPSH, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda.

- Shkresa nr. 2418/2 prot, datë 10.05.2017, “Dërgohet informacion pasuror për disa shtetas” ardhur nga DPSH, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda.
- Shkresa nr. 2418/22 prot, datë 08.06.2017, “Dërgohet informacion pasuror për disa shtetas” ardhur nga DPSH, Drejtoria për Hetimin e Krimit të Organizuar dhe Krimet e Rënda.
- Procesverbale Sekuestrimi, së bashku me vendimet për vlerësimin e sekuestros.
- Relacionet “Mbi verifikimin e Pasurive për shtetasit e përfshirë në p.penal nr. 63”
- Shkresa nr. 43 Akti, datë 30.4.2018, përmes të cilit është përcjellë Vendimi “Për dërgimin e çështjes në gjyq”.

42. Gjykata vlerësin që, kërkesa e paraqitur nga akuza është konform parashikimeve të ligjit nr.10192, datë 3.12.2009, “*Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 24/2014 dhe me ligjin nr. 70/2017, duke u plotësuar kriteri ligjor i parashikuar nga neni 3, pika 1, germa “a” e tij, pasi për shtetasit A.M., dhe A.N. (M.), ekziston një dyshim i arsyeshëm i bazuar në idicie, madje akoma më tej ka prova të mjaftueshme, duke qenë se, janë dërguar për gjykim, për kryerjen e veprave penale të: “*Vjedhja e bankave*”, më shumë se njëherë, në formën e Grupit të strukturuar, “*Krijimit dhe pjesëmarrjes në grup të strukturuar kriminal*”, të parashikuar nga nënet 136/2, 28/4, 333/a/1, 2 dhe 334/1 të Kodit Penal dhe ndaj tyre dhe familjarëve të tyre, janë identifikuar pasuri të cilat zotërohen plotësisht ose pjesërisht, në mënyrë të drejtëpërdrejtë ose të tërthortë dhe, për këtë arsye është e nevojshme zbatimi i masave parandaluese ndaj pasurisë.

43. Po ashtu, gjykata vlerëson, në interpretim të nenit 11 të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009 se, plotësohen, njëkohësisht dy kriteret e përgjithshme për zbatimin e masave parandaluese ndaj pasurisë që kanë të bëjnë me: 1. Ekzistencën e dyshimit të arsyeshëm, të bazuar në idicie që tregojnë se, personat mund të jenë përfshirë në veprimtari kriminale dhe 2. Zotërimi i pasurive apo të ardhurave, që nuk i përgjigjen dukshëm nivelit të të ardhurave, fitimeve apo veprimtarive të ligjshme, të deklaruara dhe as nuk justifikohen prej tyre; si dhe të paktën njërit prej kriterëve të veçanta, të parashikuara në pikat “a” dhe “b” të këtij neni.

44. Në rastin konkret plotësohet pika a e këtij neni, duke ekzistuar rreziku real për humbje, marrje apo tjetërsim të fondeve, pasurive apo të drejtave të tjera, mbi të cilat parashikohet vënia në zbatim e masës së konfiskimit, sipas dispozitave të këtij ligji, pasi nëse subjekti i dyshuar “pronar” A.(Sh.) M., A.M. (N.), apo personat e lidhur A.A.dhje I.(C.) M.mund të kryejnë veprime juridike për tjetërsimin e pasurisë së identifikuar në emër të tyre.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata, në bazë të nenit 3 pika 1 gërma “d”, nenit 5 pika 3, nenit 7 pika 1 dhe 2, nenit 11 pika 1 gërma “a”, nenit 12 pika 1 dhe 2, nenit 14 pika 2 dhe 3, nenit 15 pika 1 të Ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009 *Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit, korrupsionit dhe krimeve të tjerë, nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë*”, ndryshuar me ligjin nr. 24/2014 dhe me ligjin nr. 70/2017;

V E N D O S I:

1. Pranimin e kërkesës së paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, Tiranë.

2. Sekuestrimin e pasurive si më poshtë vijon:

XVII. Pasuri garazh me sip. 23 m², në emër të shtetasit A.M., Zona kadastrale 2183, vol 7, faqe 46, data e leshimit të certifikatës 12.4.2016, blerë me kontratën e shitblerjes, nr. 387 rep; nr. 203 kol. datë 26.3.2016 nga shoqëria “Al-Konstruksion”, me përfaqësues ligjor shtetasi Besim Ismaili në vlerën 4.000 USD.

XVIII. Pasuri apartament me sip. 100.5 m², në emër të shtetasit A.M., Zona Kadastrale 2183, vol 7, faqe 146., blerë nga shoqëria “Al-Konstruksion”, me përfaqësues ligjor shtetasi B.I., me kontratën e shitblerjes nr. 386 rep; nr. 202 kol. datë 26.3.2016, për shumën 41.740 dollarë.

XIX. Pasuri e llojit truall, në emër të shtetasit Sh.M. (A.M.), ZK. 3866, Nr.Pasurisë 312/202, Vol.57, Fq.95, lloji i pasurisë truall, Sip.473.50 m². fituar me kontratën nr. 2774 rep. nr. 928 kol. datë 3.6.2008, në shumën 2.998.500 lekë, me adresë Yzberisht, Tiranë dhe është regjistruar në datë 7.5.2012.

XX. Pasuri e llojit apartament me sipërfaqe 71 m², ne emër të shtetasës A.A., ndodhur në zonën kadastrale të qytetit Sarandë nr. 8641-8642, volum 17, faqe 28., blerë nga shoqëria Tulo shpk me kontraten nr. 265 rep; nr. 52/1 kol në datë 13.1.2013 te noteri Genc Nikolla, në shumën 3.698.316 lekë, ku në këtë kontratë sipas prokurës së posaçme, datë 12. 1.2013, kjo shtetase është përfaqësuar nga shtetasi A.A. M. .

XXI. Pemetore me sipërfaqe 608 m² në Mjull, Bathore, Tiranë, në emër të shtetasës A. A., blere nga nga shtetasi I.K., me datë 5.4.2013, kundrejt shumës 1.200.000 lekë, sipas kontratës me Nr. rep.1823, Nr. kol.36,3 të nënshkruar përpara noteres Ardjana Mehdi-Hoxha.

XXII. Apartament banimi i ndodhur në Sarandë, zona turizëm, Kanali i Çukës, i porositur në datë 5.7.2012 tek shoqëria “Tulo” shpk për ndërtim, kundrejt shumës 90.000 EURO, sipas kontratës së porosisë Nr. rep.3283, Nr. kol.1156, të nënshkruara përpara noter Genci Nikolla.

XXIII. Vila dy katëshe e ndodhur në fshatin Prezë, Vorë, në pronësi të shtetasit A.M. (N.) e blerë nga shtetasi D.C., aktualisht në këtë banesë nuk banon asnjëri dhe herë pas here shkon bashkëshortja e shtetasit A.M. , e cila bën pastrimin e kësaj ndërtese.

XXIV. Automjet i llojit BMË X6, me targa xxxxxx sekuestruar shtetasit C.M.

XXV. Automjet i llojit Fuoristrade Mercedes Benz, sekuestruar shtetasit C.M. .

XXVI. Automjeti fuoristrade BMË X3, me targa xxx xxxxxx xx, sekuestruar të pandehurit A.M. .

XXVII. Automjet i markës DODGE, me targa xx xxx xx, sekuestruar shtetasit C.M.

XXVIII. Automjet i markës DODGE, me targa xx xxxxxxxx, sekuestruar shtetasit C.M.

XXIX. Automjet i markës Mitsubishi, ngjyrë gri, pa targa, sekuestruar shtetasit C.M.

XXX. Automjet i markës Volsëagen Tiguan me targa xx xxx xx, sekuestruar shtetasit C. M.

XXXI. Automjeti i markës Land Rover model Defender me targa xx-xxx- xx. sekuestruar C.M., me datë 14.2.2017.

XXXII. Një motocikletë tip BMË model R1200 me targë xx-xxx, sekuestruar në banesën e A.M. , çelësat dorëzuar nga C.M.;

3. Për Administrimin dhe përdorimin e pasurive të luajtshme dhe paluajtshme të ngarkohet znj. Eglantina Osmanlli, e cila është administratore e Agjencisë për Administrimin e Pasurive të Sekuestruara dhe të Konfiskuara, pranë Ministrisë së Financave Tiranë.

4. Për ekzekutimin e këtij vendimi të ngarkohet oficerët e policisë gjyqësore në Drejtorinë e Përgjithshme të Policisë së Shtetit, të cilët pikës 4 të nenit 14 të ligjit nr. 10192 datë 3.12.2009, detyrohen që t'i bëjnë njoftimin e këtij vendimi personave që ju janë sekuestruar pasuritë dhe që janë përmendur në pjesën hyrëse të këtij vendimi.

5. U shpall, në Tiranë, sot me datë 25.3.2019.

SEKRETARE

GJYQTAR

EMIRJONA PAHUMI

LUAN HASNEZIRI

